



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:178486

Datë: 27.07.2023

Numri i dokumentit: 04530519

**PKR.nr.02/21**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

#### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,**

trupi gjykues në përbërja nga gjyqtarët: Habib Zeqiri-kryetar, Fitore Daci dhe Bekim Salihu-anëtar, me asistim të procesmbajtëses Albana Ujupi, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër te pandehurit L.L., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.193/20 e datës 12.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë publik me datë 04.07.2023, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij Av. Naim Ferati, të njëjtën datë mori dhe shpalli kurse me datë 27.07.2023 kryetari i trupit gjykues përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I pandehuri:**

**L. L.** i lindur me datën ....., nga i ati S., e ëma Z., e vajzërisë L., me vendbanim në rrugën “ ... “ Komuna Ferizaj, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar baba i tre fëmijëve, tregtar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse më datë 19 shtator 2020 në Kaçanik, në bashkryerje kanë vënë në qarkullim paratë e falsifikuara edhe pse e kanë ditur se janë të falsifikuara, në atë mënyre që i pandehuri L.L. i cili posedon një market me emrin “ ... “ në Ferizaj i’ a ka dhënë të pandehurit M.M. 61 monedha të metalit ne vlere nga 2 euro të falsifikuara, për të vënë në qarkullim duke ndërruar me

kartëmonedha të letrës, i cili pastaj ka shkuar në Kaçanik në barnatoren “...” dhe i ka zëvendësuar 25 monedha të metalit nga 2 euro dhe ka marr 50 euro të letrës nga punëtorja A. L, e pastaj ka shkuar të marketi “... “ në Kaçanik dhe ka kërkuar që ti ndërroj edhe 36 monedha të metalit nga 2 euro, mirëpo pronari A. K. kishte dyshuar se paratë janë të falsifikuara me ç’ rast ka njoftuar policinë të cilët i kishte sekuestruar përkohësisht paratë e falsifikuara.

**-Me të cilën ka kryer veprën penale bashkëkryerje falsifikim i parasë nga neni 296 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 70, 71, të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurit i;

### **GJYKON**

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 500 € (pesëqind euro) të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiroj ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për njëzetë /20/ euro gjobë të papaguara, i akuzuari do të vuaj një /1/ ditë burg.

Konfiskohet në mënyrë të përhershme: monedhat e metalit prej 61x2 euro.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës dhe atë për paushall gjyqësorë të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro) dhe në emër Fondit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) të gjitha brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

Të dëmtuarit: A. K. nga Kaçaniku rr. ‘...’ dhe A. L. nga Kaçaniku rr. ‘...’, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.

## A r s y e t i m i

Prokuroria e Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/L.nr.193/20 të dt. 12.01.2021 me të cilën i ka ngarkuar të pandehurit M. M. dhe L.L., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje falsifikim i parasë nga neni 296 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, në këtë gjykatë me datë 04.07.2023 ka mbajtur seancën gjyqësore, në të cilën nuk ishte i pranishëm i pandehuri M. M., ku sipas shkresës së policisë së datës 07.04.2023, i njëjti gjendet në shtetin e Francës, andaj gjykata konform nenit 35 të KPPK-së morri, Aktvendim me të cilin e veçoi procedurën penale ndaj të pandehurit M. M.

I pandehuri L. L. në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale bashkëkryerje falsifikim i parasë nga neni 296 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me të cilën e ka ngarkuar akuza duke premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale tjera apo të ngjashme. Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilin e ngarkon aktakuza në të gjitha pikat e saj, i cili pranim është në përputhje me kriteret e përcaktuara me neni 242 par.1 të KPPK-së, pasi që i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës dhe atë: Raporti i oficerit i datës 19.09.2020, dy vërtetime mbi sekuestrimin e sendeve i datës 19.09.202, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 02.12.2020, raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/.....50 i datës 27.10.2020, fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e parashikuara më lartë, kryetari i trupit gjykues konform nenit 322 par.4 të KPPK-së ka vlerësuar se janë përmbushur kriteret konform nenit 242 par.2 të KPPK-së, dhe se nuk është i nevojshëm vërtetimi i ndonjë fakti relevant, andaj ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se është vërtetuar gjendja faktike përveç provave të administruara që gjenden në shkresat e lëndës si dhe vete pranimi i fajësisë nga ana

e te pandehurit, i ka propozoj gjykatës qe te pandehurin ta shpall fajtor, ndërsa me rastin e caktimit te lartësisë se dënimit i ka propozuar trupit gjykues qe te mirët si rrethane lehtësuese pranimi i fajësisë nga i pandehuri, pendimi e tij te thellë, bashkëpunimin i tij ne te gjitha fazat te procedurës penale si dhe gjendjen e tij ekonomike.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Naim Ferati në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas konsultimin me të mbrojturin tim lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit te fajësisë, i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë me vetëdije dhe me vullnet të lire, ka ndjere keqardhje, duke e lutur gjykatën që gjate marrjes se vendimi lidhur me sanksionin penal merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e tij, i njëjti nuk ka qene i dënuar me pare për ndonjë vepër penale, është mbajtës i familjes dhe kujdeset për bashkëshorten e cila është ne gjendje të rënduar shëndetësorë. I pandehuri L. L. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale bashkëkryerje falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv e këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, i papune, realizon të ardhura financiare si veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi veprimin e të pandehurit pastaj shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj në kuptim të gjitha këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoj me dënim të pacaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i shqiptuar të pandehurit dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim me pëlqimin e të njëjtit konform nenit 44 të KPRK-së, i është zëvendësuar me gjobë në lartësi prej 500 €, me të cilat dënime do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të nenit 38 të KPRK-së që të njëjtin ta parandalojë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiroj ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti në pajtim me nenin 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për njëzetë /20/ euro gjobë të papaguara, i akuzuari do të vuaj një /1/ ditë burg.

Konform nenit 269 par.3 të KPRK-së është konfiskuar në mënyrë të përhershme monedha e metalit prej 61x2 euro

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marr në kuptim të dispozitës së nenit 449 par. 2 nën par.2.6 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Të dëmtuarit: A. K. nga Kaçaniku rr. ‘...’ dhe A. L. nga Kaçaniku rr. ‘...’, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontest civil konform nenit 462 të KPP-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr.02/21 dt. 27.07.2023**

**Zyrtarja ligjore**  
**Albana Ujupi**

**Kryetari i trupit gjykues**  
**Habib Zeqiri**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.